

KËRKESË
Nr. 980/7, datë 11.11.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion rruga ‘Marin Biçikemi’”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Shkodër

Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “truall”, bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat fizikë ose juridikë që preken nga realizimi i këtij projekti, emri i të cilëve pasqyrohet në tabelën e publikuar, si dhe personat fizikë ose juridikë, të cilët preken, por nuk figurojnë në këtë listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Shkodër, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 859,611 lekë (tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI "RIKONSTRUKSION
RRUGA MARIN BIÇIKEMI"

Nr.	PRONARI			TË DHËNA KADASTRALE									VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM						VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME		
													Truall			Ndërtesë banimi				(kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)		
	Emri	Atësia	Mbiemri	Qyteti	Z. kadastrale	Indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m²)	Truall (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)				
	A	B	C	Ç	D	E	F		G	H	I	J	K	L	M				Q	R		
1	FRANÇESKO		GJELOSHI	Shkodër	8593	M-9	4/343	TRUALL	101	101	23	119	101	8511	859,611	56	0	-	859,611	Objekt i shembur		
2	SHTET			Shkodër	8593	M-9	4/269	RRUGE	163.75	163.75	41	49	100	0	-				-			
3	SHTET			Shkodër	8593	M-9	4/265	RRUGE	295	295	9	49	179.73	0	-				-			
4	SHTET			Shkodër	8593	M-9	4/760	TRUALL	78.61	78.61	36	218	56.75	0	-				-			
5	PVN SHPK			Shkodër	8593	M-9	4/676-B2	TRUALL	608	608	29	207	43	0	-				-	Kjo pasuri bie në shesh funksional pallati, menaxhuar me leje ndërtimi		
6	DEDE		FUSHAJ	Shkodër	8593	M-9	4/667	TRUALL	932.3	932.3	27	86	105.68	0	-				-	Kjo pasuri bie në shesh funksional pallati, menaxhuar me leje ndërtimi		
TOTAL														859,611			-			859,611		